

Kupa e Pavarise/ Shkendija e Tetoves i bashkohet turneut

nga AlbaniaSoccer

E martë, 26 Nentor 2013 22:43



Shkendija e Tetoves do te marre pjese ne turneun festiv qe do te zhvillohet ne Vlore. Drejtuesit e skuadres shqiptare ne Maqedoni i kane kthyer pergjigje pozitive FSHF-se per ndeshjen qe bashkon kater skuadrat shqiptare ne ate qe tifozet e quajne "Shqiperi Etnike". Flamurtari si vendi prites, Prishtina, Otranto dhe Shkendija e Tetoves jane ekipet qe do te luajne te enjten ne Vlore, ne turneun qe organizohet cdo vit per te festuar Shqiperine e pavarur ne daten 28 nentor.